



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Qershor 2022

Nr: 180

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS
“QENDRESA QYTETARE” NDAJ ZJ. ERISELDA SEFA, KANDIDAT PËR KRYETAR
TË BASHKISË LUSHNJË, Z. HAKI ÇAKO DREJTOR I AGJENCISË KOMBËTARE
TË MBROJTJES CIVILE DHE SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E
SHQIPËRISË”, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS
ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË
DATËS 6 MARS 2022

Sot më datë 30 Qershor 2022, Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Organizata “Qendresa Qytetare”

Objekti: Veprime të institucioneve publike në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Zj. Eriselda Sefa, Kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnjë
Z. Haki Çako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 21, shkronja “dh” dhe 91, 171, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 23, 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter



Data: 30 Qershor 2022
Nr. 180

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Eriselda Sefa, candidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 26.02.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së, është raportuar denoncimi me nr. 3606 ID, ku pretendohet se: *“Në datë 20.02.2022, në fshatin Thanasaj, në praninë e kandidatës së PSSH për kryetare të bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa dhe drejtuesit politik për qarkun e Fierit, Taulant Balla, Drejtori i Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, ka vizituar punimet e investimeve mbi lumin Shkumbin të financuara nga fondi i AKMC, duke promovuar edhe investimet e ardhshme. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore në referim të vendimit nr. 2, pika 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të republikës së Shqipërisë, pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në një veprimtari të ndaluar, në referim të nenit 3, pika 1.1/b, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ku kanë promovuar investimet me interes publik, aktivitet i cili nuk rezulton të jetë njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore”.* Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike si dhe provat në link.

Provat: Link:

1- <https://fb.watch/bkKNTt4UdL/>

2- <https://www.facebook.com.eriselda.sefa1/posts/119908377272722>

3- <https://www.facebook.com/b.taulant/posts/485733019584909>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.



3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues “Qendresa Qytetare” përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj të denoncuarve zj. Eriselda Sefa kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
5. Në lidhje me të denoncuarin, subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, duke ju referuar vendimit nr. 19, datë 31.05.2022, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ku thuhet se *“Zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”*, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ. Pavarësisht se ka qenë subjekt i denoncimit, për arsyen e sipërpërmendur, nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.
6. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnjë dhe z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për të cilët atribuohen veprimtari administrative që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
8. Në denoncimin e raportuar pretendohet se, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, në praninë e kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa dhe drejtuesit politik për qarkun e Fierit, Taulant Balla, Drejtori i Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako ka vizituar punimet e investimeve mbi lumin Shkumbin të financuara nga fondi i AKMC, duke promovuar edhe investimet e ardhshme. Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1296 prot., datë 28.02.2022, ka kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë dhe subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
9. Me shkresën nr. 1635 prot., datë 07.03.2022 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe me shkresën nr. 1638 prot., datë 07.03.2022 drejtuar Bashkisë Lushnjë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kërkuar sërish informacion nga institucionet përkatëse pasi nuk rezulton e qartë se kush ka qenë organizatori i këtyre aktiviteteve.
10. Me shkresën nr. 398/1 prot., datë 03.03.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1296/1, datë 04.03.2022, z. Haki Çako në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sqaron se: *“...vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Bashkinë e Lushnjës është bërë në kuadër të inspektimit të punimeve të investimit “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Shkumbin në zonën Thanasaj, Lushnjë” dhe në përmbushje të detyrës funksionale dhe misionit të agjencisë, inspektimi i punimeve ka qenë i planifikuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”.*
11. Për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi, pas përfundimit të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të shqyrtimit të këtij denoncimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 147, datë 26.04.2022 vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të

denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe zj. Eriselda Sefa propozuar si kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

12. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vijim të procesit të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm, me shkresën nr. 2383 prot., datë 13.05.2022, i përcjell për njohje palëve në proces kopje të njehsuar me origjinalin të shkresës nr. 398/1 prot., datë 03.03.2022, administruar me tonën nr. 1296/1 prot., datë 04.0.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako.
13. Në përgjigje të njohjeve mbi gjetjet e denoncimit, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, me shkresën nr. 398/5 prot., datë 18.05.2022, administruar me tonën nr. 2383/1 prot., datë 20.05.2022, sqaron se, “...angazhimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, konkretisht vizita e Drejtorit të Përgjithshëm në fshatin Thanasaj të bashkisë Lushnjë, është kryer në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në kuadër të inspektimit të ecurisë dhe problematikave të hasura në zbatimin e projektit “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Shkumbin, në krahun e majtë të zonës Thanasaj”. ...gjatë procesit zgjedhor, AKMC nuk ka vendosur në dispozicion të ndonjë subjekti zgjedhor, burimet financiare/ njerëzore apo materiale. Këto burime janë përdorur vetëm për kryerjen e veprimtarisë institucionale në përmbushje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
14. Bashkëlidhur shkresës në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është vënë:
 - Shkresa nr. 5127/6 prot., datë 29.07.2021 e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, administruar nga AKMC nr. 1464/4 prot., datë 30.07.2021, me lëndë “Mbi rehabilitimin e objekteve të mbrojtjes nga përmbytja”;
 - Shkresa nr. 1464/7 prot., datë 16.08.2021 e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, drejtuar titullarit të Autoritetit Kontraktor, me lëndë “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja”;
 - Shkresa nr. 1892/1 prot., datë 30.08.2021 e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, drejtuar titullarit të Autoritetit Kontraktor, me lëndë “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja”;
 - Urdhër nr. 1862, datë 21.12.2021 i titullarit të Autoritetit Kontraktor “Për lidhje dhe zbatim kontrate”;

- Kartelë shqëruese e praktikës.
15. Organizata “Qendresa Qytetare” ka paraqitur prapësimet e saj, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2459 prot., datë 25.05.2022, ku sqaron se: *“...pretendimet nuk janë të bazuara në ligj dhe prova. Fondet për këtë vepër publike janë alokuar 2 muaj përpara zgjedhjeve vendore duke e bërë promovimin e këtij investimi një veprimtari të ndaluar për t’u promovuar; duke shkelur kështu parashikimet e neneve 91, 92, 172 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator”.*
 16. Me shkresën nr. 4303/1 prot., datë 23.05.2022, administruar me tonën nr. 2383/2 prot., datë 24.05.2022, Bashkia Lushnjë sqaron se: *“Në territorin e Bashkisë Lushnjë janë duke u kryer punime në zbatim të kontratës me nr prot 1892/16 datë 22.12.2021 të nënshkruar midis Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe “FLED” shpk, me objekt “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Shkumbin në zonën Thanasaj, Lushnjë”. Institucioni i Bashkisë Lushnjë, me vendimin nr. 11, datë 18.01.2022 ka miratuar deklaratën për kryerje punimesh në fshatin Thanasaj, Njësia Administrative Dusha, Bashkia Lushnjë. Në këtë kontekst, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të funksioneve dhe detyrave të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe konkretisht të njësisë ku po zbatohet ky projekt shumë i rëndësishëm për zonën, kryetarja në detyrë e bashkisë kryen vizita inspektuese të herëpashershme. Në një nga këto vizita të saj në zonën ku po kryhet investimi rastësisht ka takuar edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile z. Haki Çako i cili ka qenë në inspektim në rolin e titullarit të autoritetit kontraktor”.*
 17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 31 Maj 2022, ora 13:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Në seancë dëgjimore u paraqit organizata “Qendresa Qytetare”, me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti. Palët e tjera në proces nuk u paraqitën në seancën dëgjimore.
 18. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësueses të organizatës “Qendresa Qytetare” e cila parashtrori pretendimet e saj në lidhje me rrethanat e faktit si më poshtë:
“Nga shkresat dhe përgjigjet që jemi njohur pretendohet se ka qenë një takim rastësor nga z. Çako, gjë e cila kundërshtohet nga faktet e administruara. Është një takim i organizuar

tepër mirë dhe me një prani të shtuar të banorëve të zonës të cilët jorastësisht ndodheshin pranë vendit ku po kryheshin punime, duke takuar zyrtarë të lartë dhe kandidatin. Natyrshëm në këto rrethana lind pyetja se kush i kishte njoftuar më parë banorët, kush ishte organizatori i këtij takimi, nëse ishte rastësor pse lindi nevoja e publikimit të detajeve mbi aktivitetin.

Gjithashtu nga shkresa e bashkisë informohemi se kompania është kontraktuar nga AKMC në datë 22.12.2022 dhe është pajisur me lejen e ndërtimit në datë 18.01.2022, pra një investim për të cilin janë vënë në dispozicion fonde vetëm dy muaj para zgjedhjeve vendore të pjesshme të datës 6 Mars. Të ndodhur në këto kushte, shihet qartë se gjendemi përpara një veprimtarie të ndaluar në referim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Ky takim vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore dhe drejtues të organeve publike marrin pjesë në një veprimtari të ndaluar, ku kanë promovuar investimet me interes publik në prani të banorëve të zonës dhe në një komunikim me video live nga profili personal i kandidates zj. Eriselda Sefa. Rrjedhimisht prezenca e z. Çako në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, implikon favorizimin e kandidatit në zgjedhje. Nga pamjet filmike, në ligjëratën e palëve është folur dhe promovuar gjatë investimi i bërë në pritën e lumit Shkumbin.

Për sa i përket pretendimit lidhur me raportimin në ndërfaqen e KQZ, siç vërehet nga pamjet e raportuara, shihet prezencë e shtuar e banorëve të zonës. Nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar në ndërfaqen e raportimeve në KQZ. Për sa më sipër kërkojmë konstatimin e shkëlqeve nga ana e Komisionerit dhe marrjen e sanksioneve administrative ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes Civile z. Haki Çako, subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidates zj. Eriselda Sefa”.

19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2754 prot., datë 20.06.2022, ka njoftuar sërish palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, për shkak se palët në proces pretendojnë se nuk kanë marrë në kohë njoftimin për seancën publike dhe nuk kanë mundur të përfaqësohen.
20. Në seancën e datës 28 Qershor 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve riçeli hetimin administrativ duke u dhënë mundësinë palëve të paraqitura për të dhënë pretendimet e tyre. Të pranishëm në seancë ishin përfaqësuesit e Organizatës “Qendresa Qytetare” zj. Teisa Kurti dhe z. Migen Qiraxhi, zj. Klodjana Hida përfaqësuese me Prokurë të Posaçme e kandidates për kryetar bashkie Lushnjë zj. Eriselda Sefa dhe z. Jonian Harka përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
21. Përfaqësuesja e kandidates për kryetar bashkie Lushnjë zj. Eriselda Sefa parashtrroi se, “Kandidatja për kryetar bashkie dhe njëkohësisht kryetarja e Bashkisë Lushnjë ka qenë në

një vizitë inspektuese në Njësinë Administrative Dushk, fshati Thanasaj, në funksion të detyrave funksionale të saj. Në këtë vizitë ka rastisur edhe Drejtori i AKMC, z. Haki Çako i cili nga ana e tij ka qenë duke kryer një vizitë inspektuese në një investim të kryer nga institucioni që ai drejton. Kryetarja e Bashkisë ka qenë në një vizitë inspektuese, siç bën në mënyrë periodike në çdo njësi. Kjo njësi administrative, duke qenë njësi kufizuese me Bashkinë e Rrogozhinës si dhe për shkak të problemeve me përmbytjet gjatë stinës së dimrit nga lumi Shkumbin, vizitohet herëpashere nga Kryetarja e Bashkisë. Nuk ka pasur një takim të organizuar në këtë rast”.

22. Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile parashtroi si vijon: *“Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC nuk përbën aktivitet zyrtar të institucionit. Vizita është kryer në funksion të përmbushjes së kontratës së investimit të realizuar, investim i cili ka nisur shtatë muaj para procesit zgjedhor. Kemi të bëjmë me një aktivitet rutinë në përmbushjen e detyrave të institucionit. Në atë periudhë ka pasur shqetësime edhe nga strukturat vendore dhe institucione të tjera mbi realizimin sa më të shpejtë të këtij investimi dhe për këtë arsye është kryer vizita, në rolin e Autoritetit Kontraktor. Ka qenë një vizitë e paplanifikuar dhe nuk ka pasur për qëllim komunikimin publik për të promovuar këtë investim, por vetëm qëllime inspektimi mbi problematikat konkrete dhe ecurinë e investimit. Institucioni jonë nuk ka vënë në asnjë moment në dispozicion të ndonjë subjekti zgjedhor burime financiare apo logjistike”.*

23. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Organizata “Qendresa Qytetare” i qendroi pretendimeve te saj duke kërkuar konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes Civile z. Haki Çako, subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidates zj. Eriselda Sefa”. Përfaqësuesja e kandidates zj. Eriselda Sefa dhe përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile kërkuan rrëzimin e pretendimeve të Organizatës “Qendresa Qytetare”.

III. Analiza ligjore

24. Neni 3, pika 1, nënndarja 1.1, shkronja “d”, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se *“Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike*

jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”.

25. Neni 3, pika 1, nëndarja 1.1, e kufizon fushën e veprimit në ato veprimtari publike për të cilat janë vënë **rishtazi apo posaçërisht në dispozicion**, apo **janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “d” “...mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”, duhet që fondet e përdorura për mbështetjen promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur rishtazi apo posaçërisht në dispozicion dhe të ishin transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Këto janë kushte kumulative të përcaktuara nga neni 3, dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra.
26. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari me fonde të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar, pasi investimi dhe procedurat për realizimin e projektit “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Shkumbin, në krahun e majtë të zonës Thanasaj”, kanë filluar 7 (shtatë) muaj para datës së zgjedhjeve, vërtetuar kjo me shkresën nr. 5127/6, datë 27.07.2021 “Mbi rehabilitimin e objekteve të mbrojtjes nga përmbytja”, shkresat nr. 1464/7, datë 16.08.2021 dhe nr. 192/1, datë 30.08.2021 “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja” si dhe urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor në Ministrinë e Mbrojtjes nr. 1862, datë 21.12.2021 “Për lidhje dhe zbatim kontrate”.
27. Kryetari i bashkisë Lushnjë, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, zj. Eriselda Sefa është paraqitur pranë zonës ku po kryhet investimi, në kuadër të vizitave inspektuese të herëpashërëshme që kryetarja e bashkisë kryen, në zbatim të funksioneve dhe detyrave të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Veprimtaria e mësipërme nuk konsiderohet e ndaluar, pasi është në përmbushje të detyrave funksionale të Kryetarit të Bashkisë. Megjithatë, në kundërshtim me çfarë ishte planifikuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kryetarja e bashkisë njëkohësisht dhe kandidat për kryetar bashkie, e propozuar nga ana e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka shfrytëzuar këtë takim për kryerjen e fushatës zgjedhore.
28. Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator dhe ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor kanë pasur si qëllim të vetëm mospërdorimin e fondeve publike në funksion të fushatave elektorale të kandidatëve për kryetar apo deputet. Përkatësisht, neni 91, pika 1, e

Kodit Zgjedhor parashikon se, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*.

29. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Eriselda Sefa, kandidat për Kryetar të Bashkisë Lushnjë, e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, duke vizituar punimet e investimeve mbi lumin Shkumbin të financuara nga fondi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe duke promovuar investimet e ardhshme, ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore, në kuptim të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Rezultoi e provuar se, veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, pasi z. Çako ka qenë në kryerjen e detyrave të tij funksionale.
30. Për veprimtaritë e ndaluara, Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi subjektet zgjedhore. Kodi Zgjedhor, në pikën 20, të nenit 2 përcakton se “subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Pika 1, e nenit 172, përcakton se *“...subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë”*. Kushti që duhet të vërtetohet nga hetimi është që veprimtaria të jetë kryer në favor të subjektit zgjedhor d.m.th. subjekti zgjedhor të ketë siguruar përfitim elektoral nga shkelja dhe që ky i fundit të mos ketë marrë masa për ndërprerjen e shkeljes, pas marrjes dijani, në rastin konkret në favor të zj. Sefa. Nuk rezultoi e provuar se cili prej institucioneve ka ftuar në këtë takim përfaqësuesin e partisë politike dhe deputetin z. Taulant Balla. Pjesëmarrja e z. Taulant Balla në takimimin e zhvilluar i jep atij karakter politik dhe mbështetës apo promovues ndaj kandidatës së Partisë Socialiste për kryetar të bashkisë Lushnjë. Pra, nga vlerësimi i përgjithshëm gjatë hetimit administrativ del qartazi përfitimi elektoral në favor të kandidatës për kryetare bashkie zj. Eriselda Sefa.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 21 shkronja “dh”, nenin 91 dhe 92, nenin 171, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.
3. Konstatimin e shkeljes administrative nga ana e zj. Eriselda Sefa, Kryetar Bashkie dhe njëkohësisht kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnjë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
4. T’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksionit administrativ për zj. Eriselda Sefa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

